

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL, DURRËS.

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Autoritetin Portual, Durrës, me objekt në Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare për periudhën 01.09.2010 deri më 31.10.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 50 datë 19.05.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 në Për kontrollin e Lartë të Shtetit, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 856/24 datë 29.05.2014, dërguar Z. Selim Belortaja, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit Portual, dhe me shkresën nr. 856/27 datë 29.05.2014, dërguar Z. Edmond Haxhinasto Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Brenda datës 30.06.2014

2. Të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, zëvendësimi i anëtarit të këshillit drejtues [REDAKTUAR] pasi është në papajtueshmëri me statutin e Autoritetit Portual Durrës të miratuar me VKM nr. 596, datë 10.09.2004 në Për miratimin e statudit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij, neni 7, për të qenë anëtarë i Këshillit Drejtues të APD, pasi ky anëtar i këshillit drejtues është dhe përfaqësues ligjor i shoqërisë [REDAKTUAR] SHPK, që ka marrëdhënie kontratuale me Autoritetin Portual Durrës. Konkretisht ka kontratën me nr. 995, datë 03.04.2013 për përpunimin e kontejnerëve nga anijet, për periudhën viti 2005 deri në vitin 2013, si dhe kontratën me nr. 719, datë 07.03.2013 me afat 1-vjeçar, për marrje qira të sipërfaqes për shesh 1500 m².

Veprime në kundërshtim me zbatim të Ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003 në Për Autoritetin Portual, neni 25 dhe VKM nr. 596, datë 10.09.2004 në Për miratimin e statudit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij, neni 11, pika 1 dhe neni 5, pika 2.

Brenda datës 30.06.2014

3. Këshilli Drejtues i Autoritetit Portual Durrës (APD) dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të analizojnë shkaqet, faktorët, përgjegjësitë për mosrealizimin e investimeve të cilat janë realizuar përkatësisht në masën 46% për vitin 2011, në masën 71% për vitin 2012 dhe në masën 64% për vitin 2013 dhe të marrë masat e duhura për ti realizuar ato në vazhdimësi.

Vazhdimisht

4. Të merren masa nga Këshilli Drejtues i APD, që mbledhjet vjetore të zhvillohen të hapura për publikun, në zbatim të Ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003 në Për Autoritetin Portual, neni 25 dhe

VKM nr. 596, datë 10.09.2004 nëPër miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tijò, neni 11 pika 3, neni 14, pika 8. *Vazhdimisht*

5.Të rishikohet Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 52, datë 18.12.2007 nëPër miratimin e rregullores për politikat dhe procedurat e përfitimit të shpërblimeve suplementareò, i cili ka përcaktuar dhënien e shpërblimit në fund të vitit në masën e një page mujore për të gjithë punonjësit e APD dhe për anëtarët e Këshillit Drejtues, pasi bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 nëPër Autoritetin Portualò, neni 11, pika 3, si dhe VKM nr. 596, datë 10.09.2004 nëPër miratimin e Statutit të Autoritetit Portual dhe për riorganizimin e tijò neni 5, pika 6.

Brenda datës 30.09.2014

6.Të përmirësohet praktika e hartimit të programeve të zhvillimit ekonomiko-financiar. APD të miratojë një udhëzim për hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e programeve ekonomike financiare ku të përcaktohen: Proceset e hartimit të programit të zhvillimit, procedurat e miratimit dhe afatet e hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programit të zhvillimit.

Vazhdimisht

7.Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financës dhe Administrimit, të merren masa për paraqitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara për Filialin e saj në Republikën e Kosovës, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 27 nëPasqyrat financiare të konsoliduara dhe individualeò.

Brenda datës 31.12.2014

8.Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financës dhe Administrimit, të merren masa për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 8 nëPolitikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimetò, Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 24 nëDhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhuraò, Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (IFRS-SNRF) 7 nëInstrumentet financiare: Shënimeò, Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 37 nëProvizionet, Pasivet dhe Aktivet e Kushtëzuaraò dhe Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 21 nëEfekti i ndryshimeve në kurset e këmbimitò, si dhe zbatimin e rekomandimeve të audituese të pavarur.

Vazhdimisht

9.Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financës dhe Administrimit, të merren masa për përshtatjen e programit kompjuterik në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 nëPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, neni 3, pika 9.

Brenda datës 30.09.2014

10.Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financës dhe Administrimit, të merren masa për pasqyrimin në shënime shpjeguese të pasqyrave financiare, pagesën e përgjithshme që i është bërë anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe Drejtorit Ekzekutiv, në përputhje me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 nëPër Autoritetin Portualò, neni 25, pika 2, germa a dhe b, si dhe VKM nr. 596, datë 10.09.2004 nëPër miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tijò, i ndryshuar, neni 9, pika 14, germa a dhe b.

Brenda datës 31.12.2014

11.Nga Drejtoria e Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financës dhe Administrimit, të merren masa që për transaksionet financiare të kryera në valutë, konvertimi në lekë gjatë vitit të kryhet me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, në përputhje me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 nëPër Autoritetin Portualò, neni 8 dhe SNK 21 nëEfekti e ndryshimit në kurset e këmbimitò, pika 22.

Vazhdimisht

12.Të rishqyrohet nga Këshilli Drejtues dhe Drejtoria e Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit Portual Durrës, gjendja në magazinë në datën 31.01.2014 e sasisë vajrave dhe lubrifikanteve **në vlerën 8,161,551.83 lekë**, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 nëPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin dhe kontrollin financiarò.

Brenda datës 30.09.2014

13.Drejtoria e Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financës dhe Administrimit, faturat për pagesat e përcaktuara në marrëveshjen me nr.1833, datë 15.07.2013 me shoqërinë ■■■■■ (■■■■■ ti lëshojë, në zbatim të pikës 5.1, të Udhëzimit nr. 17, datë 30.08.2008 të Ministrisë së Financave nëPër tatimin mbi vlerën e shtuarò.

Vazhdimisht

14.Nga Drejtoria e Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financës dhe Administrimit, të merren masa që para çeljes së depozitave bankare, të kryhet një analizë e mirëfillt e tregut financiar, për të parë mundësinë e përfitimit të interesave, si dhe në veçanti thyerja (prishja) e depozitave të bëhet në raste të jashtëzakonshme dhe e arsyetuar për domosdoshërinë e krijuar, pasi grupi i auditimit për periudhën 2010-2013, ka konstatuar se janë kryer thyerje (prishje) të depozitave bankare të çelura më parë, të paarsyetuara për domosdoshmërinë e këtyre veprimeve, për të cilat APD-së i janë krijuar të **ardhura të munguara, në vlerën 51,161 euro dhe 202,703 lekë**.

Vazhdimisht

15.Nga Drejtoria e Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të merren masa për hartimin dhe përpilimin e kontratave të sponsorizimeve, që mund të bëhen në të ardhmen, me të gjitha modalitetet e nevojshme juridik të një kontrate, në zbatim të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 nëKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 nëPër sponsorizimetò, i ndryshuar.

Vazhdimisht

16.Nga Drejtoria e Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financës dhe Administrimit, të merren masa për nxjerrjen jashtë përdorimit të inventarit ekonomik, pajisjeve, pjesëve këmbimit, aktive afatgjata, të hartohet dokumentacionin i plotë, ku të pasqyrohen shkaqet e nxjerrjes jashtë përdorimit, karakteristika dhe gjendja e vlerave materiale, koha e përdorimit, shkaktarët e prishjeve e të dëmtimeve (në se ka), në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 nëPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, neni 6, pika 1, germa e, dhe Udhëzimin e

Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 102.

Brenda datës 31.12.2014

17.Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues i APD, të analizojë gjendjen debitore dhe kreditore më datë 31.12.2012, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre, në zbatim të Ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003 nëPër Autoritetin Portualò, nenet 15 dhe 25, VKM nr. 596, datë 10.09.2004 nëPër miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tijò, neni 9, pika 14, neni 14, pika 8, dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 69, datë 15.10.2012 nëMbi miratimin e rregullores nëPër organizimin dhe menaxhimin e Autoritetit Portual Durrësò, pika 4/8, germa h.

Brenda datës 30.09.2014

18.Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të zbatohen procedurat ligjore lidhur me procesin e kryerjes së inventarizimeve dhe azgjesimeve të aktiveve afat gjata materiale, jo materiale dhe financiare, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 nëPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, neni 6, pika 1, germa e, dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 82.

Vazhdimisht

19.Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues i APD, të analizojë gjendjen debitore dhe kreditore më datë 31.12.2012, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre, në zbatim të Ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003 nëPër Autoritetin Portualò, nenet 15 dhe 25, VKM nr. 596, datë 10.09.2004 nëPër miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tijò, neni 9, pika 14, neni 14, pika 8, dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 69, datë 15.10.2012 nëMbi miratimin e rregullores nëPër organizimin dhe menaxhimin e Autoritetit Portual Durrësò, pika 4/8, germa h.

Brenda datës 30.09.2014

20.Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i APD, të merren masat që të vihet në përdorim peshorja elektronike blerë me kontratën me numër reference 53PH 2012, pa datë të përcaktuar me vlerë 47,994,000 lekë, e cila nga auditimi rezultoi e pa vënë punë që nga data 16.10.2013, që është kryer kolaudimi i peshores elektronike deri më datën 31.01.2014, njëqind e gjashtë (106) ditë. Investim i cili nuk ka justifikuar kryerjen e këtij shpenzimi, që ka të bëjë me instalimin e sistemit të integruar të peshimit elektronik, i cili duhet të përshpejtojë procedurat e brendshme të operimit, rritjen e sigurisë së veprimeve të brendshme, miradministrimin e të ardhurave të autoritetit Portual, si dhe rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit përkundrejt operatorëve. Për vënien në punë të peshores elektronike të bashkëpunohet me Degën e Doganës Durrës.

Brenda datës 30.06.2014

21. Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i APD-së, ti kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt. Procedurat e prokurimit nëBlerje me vlera të voglaò, të bëhen

vetëm mbi bazën e argumentimeve ligjore për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure dhe gjithmonë në përputhje me përcaktimet ligjore.

Vazhdimisht

22.Për të gjitha kontratat e qirave të lidhura nga APD, me subjektet përkatëse, qiramarrëse, për sipërfaqe deri në 200 m² dhe me afat deri në një vit, të bëhet plotësimi i dosjeve, me dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve në VKM nr. 529, datë 08.06.2011 nëPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, kreu II nëProcedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore, pika 7 e tij.

Brenda datës 30.06.2014

23.Të revokohet urdhri i brendshëm i Drejtorit Ekzekutiv nr. 506, datë 17.02.2009 nëMbi dokumentacionin që duhet të paraqesin subjektet, që marrin me qira pasurinë e APD-së, për arsye se është nxjerrë në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 nëPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, në lidhje me plotësimin e dosjes së subjekteve kontraktuese, pasi ky urdhër nuk ka të përcaktuar dokumentacionin përkatës.

Brenda datës 30.06.2014

24.Për të gjitha kontratat e qirave të lidhura nga APD, për dhënien me qira të pasurisë, nga strukturat e monitorimit të kontratave, të mbahen akt rakordime me subjektet përkatëse qiramarrëse, për respektimin e kushteve të kontratës, sipas përcaktimeve në VKM nr. 529, datë 08.06.2011 nëPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, kreu VI nëMonitorimi i kontratave, pika 2 e tij.

Vazhdimisht

25.Të behët plotësimi i dosjes së subjektit [REDAKTUAR] me dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve në VKM nr. 529, datë 08.06.2011 nëPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, kreu II nëProcedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore, pika 7 e tij.

Brenda datës 30.06.2014

26.Për të gjitha subjektet që nuk kanë likuiduar detyrimet ndaj APD-së, sipas afateve të përcaktuara në kushtet e kontratave të lidhura, Drejtoria Ekzekutive të marrë masa, për ndalimin e përdorimit të shërbimeve në ambientet e portit, prej tyre, bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 15.12.2011 nëMbi miratimin e normës së interesit, limitit të debisë dhe afatit të pagesës në APD, pika 3, deri në likuidimin e plotë të detyrimit.

Menjëherë

27.APD-ja të marrë nga operatorët [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] planin e marketingut të detajuar, informacion mbi zhvillimin, aprovimin, zbatimin, aplikimin e një sistemi të sigurisë dhe shëndetit në punë, informacion mbi uniformat e punës dhe veshjet e sigurisë, ndihma e shpejtë, informacion mbi aksidentet në punë, aksidentet në qarkullim, raportimin e dëmtimeve dhe raportim për incidentet e mjedisit, informacion mbi aplikimin e mbrojtjes së mjedisit, sistemi i

menaxhimit të mbetjeve dhe të dhënat për shkatërrimin e substancave të rrezikshme konform kontratës, informacion mbi kushte higjienike në kuzhina, dhomat e ngrënies dhe të pritjes, ofiçina, magazina zonat e punës në kalata, sheshe magazine të përdorura nga stivadoret, plan izolimi për menaxhimin, depozitimin, transferimin e mallrave të klasifikuara si/të rrezikshme, informacion në lidhje me sistemin e rrjetit kompjuterik konform kontratave të lidhura.

Brenda datës 30.06.2014

28.Të rinegociohet kontrata e koncesionit datë 22.06.2011, në lidhje me nivelin e investimit të operatorit sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet MPPT dhe [REDACTED] sh.a., më datë 31.08.2009, pika nënë, faqe 4, ku përcaktohet se: *...në terminalin e kryhet në maksimumin 5 faza, ku punimet për fazën e parë, të jenë jo më pak se 40 milion euro që të shërbejnë kapaciteteve prej 150,000 TEU/vit dhe të përfundojë brenda 3 (tre) viteve nga nënshkrimi i kontratës koncesionare. Investimi të realizohet kundrejt investimeve të kryera nga koncesionari, me financimin e tij dhe kredi bankave të nivelit të dytë shqiptare dhe të huaja....*, pasi vlera e investimeve që do të realizohet sipas projektit, **rezulton me një diferencë në 2,220,000 mijë lekë më pak se marrëveshja e cituar më sipër.**

Brenda datës 31.12.2014

29.Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe APD, të përcaktojnë sipërfaqen e Terminalit të Kontenierëve, sipas kufijve të përcaktuar në master-planin e miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr. 546, datë 28.05.2009 nëpër miratimin e master planit për zhvillimin e Portin e Durrësit.

Brenda datës 30.09.2014

30.Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe APD, të rinegociojnë pagesën e tarifës së qirasë së tokës [REDACTED] me [REDACTED] sh.a., pasi mosaplikimi i së cilës shkakton të ardhura të munguara për APD në vlerën 814,207,520 lekë (e llogaritur 544 lekë/m²/vit x 42,763 m² sipërfaqen aktuale të terminalit x 35 vite), si dhe sjell diferencime ndërmjet operatorëve.

Brenda datës 30.09.2014

31.Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe APD, të rishikojnë klauzolën e parashikuar në kontratën koncesionare datë 22.06.2011, ku përcaktohet se: *...pasi të jetë zbritur TVSh dhe tatim fitimi, (nëse aplikohen)*, për arsye se ky ndryshim është bërë në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Koncesionit dhe ofertën e paraqitur në procedurën konkurruese nga bashkimi i operatorëve ekonomik dhe të shpallur fitues nga autoriteti kontraktor.

Brenda datës 30.09.2014

32.Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe APD, të rishikojnë kontratën e koncesionit datë 22.06.2011, për arsye se në nenin 17.1.3, të saj, janë referuar neneve, të cilët nuk gjenden në kontratë, përkatësisht nenet 17.1.4, 17.1.5, 17.1.6, 17.2.1 dhe 17.2.2. Këto nene kanë të bëjnë me bazën ligjore që mbron autoritetin kontraktor nga shkelje të mundshme të kontratës nga koncesionari. Neni 17.1.3 nëpenalitetet e tjera të kontratës është i pa zbatueshëm, pasi i referohet neneve që nuk janë në këtë kontratë.

Brenda datës 30.09.2014

33.Njësitë e Zbatimit të Projekteve Koncesionare, të ndjekin zbatimin e kontratave koncesionare dhe periodikisht t'ia raportojnë, Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, sipas përcaktimeve në urdhrat e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për ngritjen e këtyre njësive.

Vazhdimisht

34.Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe APD, të aplikojë sanksione për mos përmbushjen brenda afatit, të detyrimit të përcaktuar, në nenin 3, pika 1, germa ñvò, të kontratës së koncesionit me objekt: ñMenaxhimi, operimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik i terminalit të kontenierëve në Portin e Durrësitò, që ka të bëjë me paraqitjen e listës së mjeteve e pajisjeve, pasi operatori ekonomik, nuk ka realizuar detyrimet e deklaruara në ofertën e koncesionit ñTabela e llogaritjes së vlerës aktuale neto të investimeve në 10 vitet e para (2011-2020)ò, në të cilin për vitet 2011, 2012 dhe 2013 ofertuesi ka parashikuar investime në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme përkatësisht në vlerat 85,470 mijë lekë, 256,520 mijë lekë dhe 264,204 mijë lekë.

Vazhdimisht

35.Të zbatohet nga Njësia e Zbatimit të Projektit të Koncesionit nenin 12.1.5 ñAksesi për inspektimò, i kontratës datë 22.06.2011, me objekt: ñMenaxhimi, operimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik i terminalit të kontenierëve në Portin e Durrësitò, për të verifikuar që projekti/infrastruktura dhe shërbimet e projektit, janë duke u shfrytëzuar dhe mirëmbajtur në përputhje me standardet e performancës, etj.

Vazhdimisht

36.Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe APD të aplikojë sanksione, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, me punonjësit e transferuar nga APD, në kundërshtim, me nenin 12, pika 1.10 të kontratës me objekt: ñMenaxhimi, operimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik i terminalit të kontenierëve në Portin e Durrësitò.

Vazhdimisht

37.Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe APD të aplikojë sanksione, për mosplotësim të nivelit të investimeve, që rrjedhin nga kjo kontratë, përkatësisht të nenit 3, pika 1.1, nenin 12, pika 1.6, të kontratës së koncesionit me objekt ñMenaxhimi, operimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik i terminalit të kontenierëve në Portin e Durrësitò.

Vazhdimisht

38. Të rinegociohet kontrata e koncesionit datë 06.05.2013 objekt: ñMenaxhimi, operimi dhe mirëmbajtja e Terminalit Lindor në Portin e Durrësitò, në lidhje me objektin e koncesionit, niveli i investimit privat dhe përqindjen (royalty) fikse për Autoritetin Portual Durrës, sipas parashikimeve të VKM nr. 546, datë 28.05.2009 ñPër miratimin e master planit për zhvillimin e Portin e Durrësitò, pasi në masterplan janë parashikuar dhe miratuar këta tregues: Objekti i koncesionit janë mineralet e nikel/krom eksport dhe qymyrit import, ndërsa në studim përfshihen ñ...ngarkimi dhe shkarkimi kryesisht i ngarkesave rifuxho, por edhe i anijeve me ngarkesa të përgjithshme/gjenerale dhe për ngarkesa për projekte sipas rastit...ò.

Brenda datës 30.09.2014

39. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës të hartojë regjistrin e koncesionit, sipas Kreut I të Parime të përgjithshme, të VKM nr. 27, datë 10.01.2007 për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesionit, i ndryshuar.

Brenda datës 30.09.2014

40. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës të rinegociojë kontratën e koncesionit datë 22.08.2013, me objekt: menaxhimi, operimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik, të Terminalit të Tragetëve, në Portin e Durrësit, në lidhje nivelin e investimit privat dhe përqindjen (royalty) fikse për Autoritetin Portual Durrës, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 546, datë 28.05.2009 për miratimin e master planit për zhvillimin e Portin e Durrësit, meqenëse terminali është rinovuar tërësisht, në një vlerë prej 22.9 milion Euro, investim i përfunduar nga APD, në fund të vitit 2012.

Brenda datës 30.09.2014

41. Ti kërkohet ILDKPKI, hetimi administrativ i veprimeve të zj. [] zj. [] zj. [], z. [] z. [] zj. [] z. [] z. [] dhe zj. [] pasi nga subjektet fituese në përfundim të draftimit të marrëveshjeve koncesionare u janë rimbursuar shpenzime administrative, në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar, neni 4, pika 1 germa a, i; neni 5, pika 1, germa c.

Menjëherë

42. Nga Autoritetin Portual Durrës, të merren masa që trajtimi i mbetjeve të rrezikshme, të trajtohen nga operatorë ekonomik, të cilët janë të pajisur e lejen e duhur mjedisore, në përputhje me Ligjin nr. 9537, datë 18.05.2006 për administrimin e mbetjeve të rrezikshme.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 936,740 lekë**, nga zj. [] me detyrë magazinierë dhe z. [] me detyrë magazinier, për diferencën 4 artikujve të rezultuar diferencë nga sondazhi i kryer në Magazinën nr. 1, përtej normave të firove ligjore, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 6, pika 1, germa e, dhe Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 89 dhe 90/c.

Brenda datës 30.06.2014

2. Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv APD dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financës dhe Administrimit, të merren masa për arkëtimin e **vlerës 134,390 lekë**, si përfitim i pa drejtë në paga dhe shtesa në paga nga 29 persona, mbështetur në nenin 27 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 kodin i punës në Republikën e Shqipërisë, sipas pasqyrës nr. 5, datë datë 31.01.2013, trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.06.2014

3.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 220,820 lekë**, nga shoqëria [REDAKTUAR] shpk, si përfitim i padrejtë në zbatim të kontratës për punë publike dhe shërbim mirëmbajtje gjelbërimi nr. 868 prot, datë 26.03.2013 dhe Ref. nr. 63 PH 2012, me objekt ËGjelbërimi i rrugës porta 4-Terminali i Trageteve, gjelbërimi i mbikalimit dhe zona të ndryshme në Port, mirëmbajtja e gjelbërimit në të gjithë territorin e APDò, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 ËMbi kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, në mospërputhje me nenin 7, paragrafi i tretë, udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 ËPër disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të ministrave ËPër mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò.

Brenda datës 30.06.2014

4.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 1,013,950 lekë**, nga shoqëria [REDAKTUAR] shpk, si përfitim i padrejtë në zbatim të punimeve shtesë referuar kontratës bazë nr. 3517 prot, datë 28.12.2012, me nr. Ref. 56 PH 2012 ËRrethimi i terminalit lindor në Portin e Durrësitò, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ËMbi kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, në mospërputhje me nenin 7, paragrafi i tretë, udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 ËPër disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave ËPër mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò.

Brenda datës 30.09.2014

5.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 556,731 lekë**, nga shoqëria [REDAKTUAR] shpk, si përfitim i padrejtë në zbatim të kontratës nr. 860 datë 25.03.2013, nr. reference 04 PH 2013 ËKalimi i shërbimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës energjitike dhe asaj elektrike operatorëve privatò, trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2014

6.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 22,800,000 lekë**, nga [REDAKTUAR] me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm ekzekutiv për periudhën 29.10.2005 deri në 08.10.2013, [REDAKTUAR] me detyrë ish-drejtor i drejtorisë inxhinierike për periudhën 15.02.2007 deri më 08.01.2014, [REDAKTUAR] me detyrë ish-drejtoreshë e drejtorisë së administrimit financiar për periudhën 23.02.2009-16.12.2013, [REDAKTUAR] me detyrë ish-drejtoreshë e drejtorisë juridike për periudhën 01.08.2007 deri më 13.01.2014. Pasi kan kryer transferimin e 2 elektrovinçave 16-27 ton shoqërisë [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR]) e përfaqësuar nga [REDAKTUAR] sipas marrëveshjes së transferimit të mjeteve të terminalit lindor me nr. 1833 prot, datë 15.07.2013, me një diferencë nga shpenzimet e kryera për remontin e tyre në vlerën 22,800,000 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me ngarkimin, shkarkimin dhe transportimin e pjesëve të elektrovinçave, e cila nuk është bërë pjesë e kostos së remontit të elektrovinçave, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, SKK dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ËPër menaxhimin dhe kontrollin financiarò. Dëmshpërblimi mbështetet në nenin 31 dhe 32 ËPërgjegjësia e personit juridikò të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 ËKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar.

Brenda datës 31.10.2014

7.Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, procedurale, përmbartimore si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 513,240 lekë**, nga shoqëria **Sh.p.k.**, si përfitim i padrejtë në zbatim të punimeve në objektin **Rrethimi i terminalit lindor në Portin e Durrësit**, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 **Mbi kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit**, me ndryshime, në mospërputhje me nenin 7, paragrafi i tretë, udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 **Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të ministrave Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit**.

Brenda datës 31.10.2014

8.Të kërkohen në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **56,498,909.97 lekë**, nga të cilat 39,960,337 lekë principal dhe 16,538,572.97 lekë kamatëvonesa, nga operatori **Sh.p.k.**, të cilat përbëjnë përqindjen e të ardhurave që i kalon APD-së nga aktiviteti i operatorit.

Brenda datës 31.12.2014

9.Të kërkohen në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **10,168,777.59 lekë**, nga operatori ekonomik **Sh.p.k.**, për arsyes se falja e detyrimeve të papaguara, nga aktiviteti i operatorit, sipas pikës 1, të vendimit të KD nr. 30, datë 15.12.2011 **Mbi faljen e detyrimeve të lindura nga aplikimi i normës së interesit**", është në kundërshtim të plotë me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 **Për autoritetin portual**, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 **Kodi i procedurës administrative në Republikës së Shqipërisë** dhe VKM nr. 596, datë 10.09.2004 **Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij**, neni 9 **Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues**.

Brenda datës 31.12.2014

10.Të kërkohen në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **9,677,043 lekë**, e cila përbëhet nga 5,983,702 lekë detyrime të palikuiduara dhe 3,693,341 lekë kamatëvonesa të paevidentuara në kontabilitet me subjektet qiramarrëse sipas listës nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, **Detyrimet e subjekteve për kontratat e lidhura nga APD-ja, për sipërfaqe deri në 200 m² dhe me afat deri në një vit**.

Brenda datës 31.12.2014

11.Të kërkohen në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **6,000,000 lekë**, nga operatori **Sh.p.k.** shuma e sigurimit të kontratës për mos likuidim në afat i detyrimeve, trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

12.Të kërkohen në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **1,867,680 lekë dhe 6,711 Euro** detyrime të papaguara nga operatorët sipas listave nr. 3, nr. 4 dhe 5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të

Auditimit, për arsye se pika 1, e vendimit të Këshilli Drejtues nr. 30, datë 15.12.2011 në Mbi faljen e detyrimeve të lindura nga aplikimi i normës së interesit", është në kundërshtim me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 në Për Autoritetin Portual, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 në Kodi i procedurës administrative në Republikës së Shqipërisë dhe VKM nr. 596, datë 10.09.2004 në Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij, neni 9 në Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues.

Brenda datës 31.12.2014

13. Të kërkohen në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **58,002 lekë**, nga subjektet qiramarrëse sipas listës nr. 6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, e cila përfaqëson përlllogaritje të pasaktë të ditëve të depozitimit të mallit.

Brenda datës 30.06.2014

14. Të kërkohen në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i detyrimeve sipas kontratave nga subjektet në [redacted] në vlerën **64,200 lekë** dhe në [redacted] në vlerën **18,700 lekë**, për periudhën 01.01.2011-31.12.2011.

Brenda datës 30.06.2014

15. Të kërkohen në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **234 euro**, nga subjektet qiramarrëse sipas listës nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, detyrime të palikuiduara dhe kamatëvonesa.

Brenda datës 30.06.2014

16. Njësia e Zbatimit të Projektit Koncesionar, të marrë masa, për arkëtimin nga subjekti koncesionar në [redacted] Sh.a., të vlerës **9,610 lekë**, që përfaqëson interesa, për likuidimin tej afatit të përcaktuar, të faturës nr. 4, datë 06.06.2013 (likuiduar me datë 08.07.2013), faturës nr. 5, datë 05.07.2013 (likuiduar me datë 29.07.2013), sipas përcaktimit në nenin 8.1.3, të kontratës koncesionare, datë 22.06.2011, amenduar me datë 24.09.2012, me objekt; në Menaxhimi, operimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik i terminalit të kontenerëve në Portin e Durrësit.

Brenda datës 31.12.2014

17. Drejtoria Ekzekutive e APD, të marrë masa për përlllogaritjen, njohjen në kontabilitet dhe arkëtimin nga subjekti koncesionar [redacted], të interesave, për faturën nr. 241, datë 31.08.2013 në vlerë **8,454,189 lekë** dhe faturën nr. 52559195 datë 30.09.2013 në vlerën **283,571 lekë**, të palikuiduara në afat, sipas përcaktimit në nenin 8.1, të kontratës së koncesionit datë 22.06.2013.

Brenda datës 31.12.2014

18. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **2,600,000 lekë**, nga nëpunësit sipas listës nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, e cila përfaqëson përfitim të padrejtë të shpenzimeve administrative nga koncesionari, për arsye se pika 4 e Urdhrave të Ministri MPPT nr. 43, datë 21.03.2011 dhe nr. 112, datë 07.08.2013 dhe

pika 5 e Urdhrit nr. 53, datë 18.04.2013, ndryshuar me Urdhrin nr. 53/1, datë 23.04.2013, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 nëPër koncesionetò, i ndryshuar.

Brenda datës 31.12.2014

C. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e dhënies me koncesion të terminalit të konteinereve, trageteve dhe terminalit lindor të zhvilluara nga MTI dhe përgjegjësisë individuale të evidentuara dhe pasqyruara për çdo procedurë, bazuar në nenin 26/1 nëKundërvajtjet administrative, pika 1, të Ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 nëPër koncesionetò i ndryshuar, ti kërkohet Agjencisë së Prokurimit Publik të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke rekomanduar marrjen e masave administrative me ngjobë në vlerën 100,000 lekëò, **në 26 raste, në total për vlerën 2,600,000 lekë**, sipas listës bashkëlidhur këtij Vendimi, për personat:

1. [REDAKTUAR] në cilësinë e kryetarit të GIP dhe anëtarit të KVO-së.
2. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të GIP, NJHDK, KVO, GNK dhe NJZPK.
3. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GIP, NJHDK, NJZPK.
4. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GIP, NJHDK, NJZPK.
5. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GIP dhe kryetarit të NJHDK.
6. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GIP, NJHDK dhe GNK.
7. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GIP, NJHDK dhe KVO-së.
8. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GIP.
9. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GIP.
10. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GIP dhe NJHDK.
11. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit GIP dhe NJHDK.
13. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GIP, NJHDK dhe GNK.
13. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të NJHDK.
14. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të NJHDK.
15. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të NJHDK.
16. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të NJHDK dhe GNK.
17. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të KVO-së dhe GNK.
18. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të KVO-së.
19. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të KVO-së.
20. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të KVO-së.
21. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GNK.
22. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GNK.
23. [REDAKTUAR] anëtarit GNK.
24. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GNK.
25. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Zbatimit të Projektit Koncesionar (NJZPK).
26. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Zbatimit të Projektit Koncesionar (NJZPK).

D. MASA DISIPLINORE

a. Bazuar në germën nëçq neni 58, kreu X nëDisiplina në Shërbimin Civilò, të Ligjit nr. 152/2013 nëPër nëpunësin civilò, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 nëPër përcaktimin e procedurës disiplinore

dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil dhe në nenin 26/1, të Ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 nëPër Koncesionetò, me ndryshime, të fillojnë procedurat ligjore për dhënien e masës disiplinore:

“Largimin nga shërbimi civil”, për:

1. zj. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtari të GIP dhe NJHDK

2. zj. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të GIP dhe NJHDK

Për arsye se:

- Nuk kanë vlerësuar me korrektësi të gjitha detajet mbi analizën e rentabilitetit, fizibilitetit dhe të përshtatshmërisë teknike të projektit të paraqitur, pasi vlera e investimeve prej 32,500,000 USD, të propozuara për përmirësimet teknike të terminalit nga koncesionari është në kundërshtim plotë me marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet MPPT dhe [REDAKTUAR] h.a., më 31.08.2009 pika nënë, me një diferencë **më pak në 2,220 milionë lekë.**

- Kanë përcaktuar kritere në kërkesat për kualifikim të Dokumenteve Standarde të Koncesionit, në kundërshtim të plotë me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 nëPër koncesionetò, i ndryshuar neni 1 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.01.2007 nëPër miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneveò i ndryshuar, Kreun IV, pika 1/b, duke cenuar barazinë e procedurave konkurruese koncesionare, pasi nga gjashtë (6) operatorë të cilët kanë blerë dokumentet e koncesionit vetëm një (1) operator është paraqitur në garë.

Kjo shkelje u konstatua në procedurën me objekt: nëMenaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik dhe financimet e lidhura me to të Terminalit të kontejnerëveò.

3. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit NJHDK.

Për arsye se:

- Ka përcaktuar kritere në kërkesat për kualifikim të Dokumenteve Standarde të Koncesionit, në kundërshtim me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 nëPër koncesionetò, i ndryshuar, neni 1 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.01.2007 nëPër miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneveò i ndryshuar, Kreun IV, pika 1/b, duke cënuar barazinë e procedurave konkurruese koncesionare, pasi nga gjashtë (6) operatorë të cilët kanë blerë dokumentet e koncesionit vetëm një (1) operator është paraqitur në garë.

Menjëherë

b. Mbështetur në kontratën kolektive të punës nr. 1851, datë 18.06.2012, neni 37, kërkojmë që ndaj personave përgjegjës të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

Pika 4 “Vëretje me paralajmërim për largim nga puna”, për:

1. znj. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në tenderin e zhvilluar me objekt nëShërbime asistence teknike për menaxhuesit e APD-sëò,

2. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në tenderin e zhvilluar me objekt nëShërbime asistence teknike për menaxhuesit e APD-së,

Për arsye se:

-Kanë kryer kualifikimin, e operatorëve ekonomik [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenet 45, 46, 53, 59 dhe 60, VKM nr. 1, datë 10.01.2007

nPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, Kreu III, V, VII DHE IX, i ndryshuar, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 nKodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar, nenet 115-120.

3. z. ■■■■■ në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në tenderin e zhvilluar me objekt nKryerja e remontit të përgjithshëm të dy elektrovinçave 16-27.5 tonò,

4. z. ■■■■■ në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave,

Për arsye se:

-Ka kryer kualifikimin e bashkimit të operatorëve n■■■■■ nga KVO, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenet 45, 46, 53, 59 dhe 60, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 nPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, Kreu III, V, VII dhe IX, të ndryshuar, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 nKodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar.

5. z. ■■■■■ me detyrë Magazinier,

Për arsye se:

Për diferencën e 6 artikujve të rezultuar diferencë nga sontazhi i kryer me zgjedhje në magazinë, në **vlerën 936,740 lekë**, përtej normave të firove ligjore, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 nPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, neni 6, pika 1, germa e, dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 89 dhe 90/c.

Pika 1, “Vërejtje me shkrim”, për:

1. z. ■■■■■ me detyrë Përgjegjës i Terminalit të Mallrave

Për arsye se:

Në zbatimin e kontratave për Shesh Përdorimi, Shesh Tranzite dhe Magazine Transite, janë konstatuar mospërputhje në llogaritje për ditët e qëndrimi, duke përdorur dy standarde brenda të njëjtës kontratë, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit me nr. 122, datë 26.01.2011 nPër përcaktimin e tarifave të shërbimit në Autoritetin Portual Durrësò.

Kjo shkelje u konstatua në dhënien me qira të ambienteve dhe trojeve të depozitimit.

2. z. ■■■■■, me detyrë Përgjegjës i Terminalit të Mallrave

Për arsye se:

-Në zbatimin e kontratave për Shesh Përdorimi, Shesh Tranzite dhe Magazine Transite, nuk përpilohej procesverbali mes palëve, për sipërfaqen e zënë, në kundërshtim me pikat 1 dhe 4 e kontratës tip, të miratuar.

Kjo shkelje është konstatuar në zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien me qira të ambienteve dhe trojeve të depozitimit.

3. zj. ■■■■■ me detyrë Koordinator/Njësia Koordinimit dhe Performancës,

4. zj. ■■■■■ me detyrë Përgjegjës/Sektori Financës.

Për arsye se:

-Nuk ka monitoruar zbatimin e kontratave të operatorëve ekonomik në [REDAKTUAR], në [REDAKTUAR] dhe në [REDAKTUAR], konform Udhëzimit nr. 2834, datë 29.09.2010 Për menaxhimin dhe monitorimin e kontratave të ngarkimit dhe të shkarkimit në portin e Durrësit, pasi operatorët nuk kanë plotësuar kushtet e përcaktuara në kontratat licencë.

Kjo shkelje u konstatuar në monitorimin e kontratave të kompanive stivadore.

Pika 5 “Largim nga puna”, për:

1. z. [REDAKTUAR] me detyrë drejtor i përgjithshëm ekzekutiv.

Për arsye se:

Në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor gjatë ushtrimit të detyrës, për sa i përket procedurave të tenderave dhe lidhjes së kontratave me objekt;

a. nëKryerja e remontit të përgjithshëm të dy elektrovinçave 16-27.5 ton, ka krijuar një dëm ekonomik për llogari të buxhetit të shtetit në vlerën 22,800,000 lekë;

- Ka kryer amendimin e kontratës me nr. 1771, datë 14.07.2011 me objekt nëKryerja e remontit të përgjithshëm të dy elektrovinçave 16-27.5 ton, amendim i cili ka shkelur barazinë në tender.

- Ka organizuar përveç tenderit nëKryerja e remontit të përgjithshëm të dy elektrovinçave 16-27.5 ton (për të cilën është lidhur kontrata me nr. 1771, datë 14.07.2011), dhe;

- tenderin për pjesë këmbimi eletriike, eletronike për vinca portual.

- tenderin për shërbimin për transportin e pjesëve të elektrovinçave.

- Ka kryer transferimin e 2 elektrovinçave 16-27 ton shoqërisë [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR]) e përfaqësuar nga [REDAKTUAR], sipas marrëveshjes së transferimit të mjeteve të terminalit lindor me nr. 1833 prot , datë 15.07.2013, me një diferencë nga shpenzimet e kryera për remontin e tyre në vlerën 22,800,000 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me ngarkimin, shkarkimin dhe transportimin e pjesëve të elektrovinçave, e cila nuk është bërë pjesë e kostos së remontit të vinçave, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 nëPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, SKK dhe udhëzimin të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin dhe kontrollin financiar.

b. Kontrata nr. 483 prot, datë 17.02.2009, me numër reference 65 PH 2008, ndërmjet Autoritetit Portual Durrës përfaqësuar nga Eduard Ndreu me detyrë drejtor i përgjithshëm ekzekutiv dhe shoqërisë në [REDAKTUAR] m.b.H, me objekt nëMirëmbajtja teknike e mjeteve mekanizmave dhe pajisjeve industriale në zotërim të APD-së, është lidhur në kundërshtim me dokumentet standarte të tenderit (terma referencës), dokument mbi bazën e të cilës është zhvilluar procedura e prokurimit. Me këtë veprim operatorët nuk janë vënë në kushte të barabarta, duke sjellë si pasojë shkeljen e barazisë në tendera, duke favorizuar operatorin ekonomik në [REDAKTUAR] m.b.H, me pagesë paraprake 32,436,781 lekë pa TVSh, pagesë e cila nuk ishte e përcaktuar në % në Dokumentet e Tenderit, (shtojca 9) si dhe duke i shtyrë afatin e fillimit të zbatimit të kontratës nga 4-muaj të përcaktuar në dokumentet e tenderit, në 6-muaj (pra me vonesë dy muaj), veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, dt. 20.11.2006, Prokurimit publik (i ndryshuar), VKM nr. 1, dt. 10.01.2007 (i ndryshuar).

2. z. [REDAKTUAR] me detyrë drejtor i drejtorisë inxhinierike.

Për arsye se:

Në funksion të detyrës si drejtor i drejtorisë inxhinierike:

-Ka ndërmarrë nismën për amendimin e kontratës me nr. 1771, datë 14.07.2011 me objekt ñKryerja e remontit të përgjithshëm të dy elektrovinqave 16-27.5 ton. Nga ky amendim jo vetëm është shkelur barazia në tender, por ka krijuar dhe dëm ekonomik për llogari të buxhetit të shtetit në vlerën 22,800,000 lekë.

- Ka organizuar përveç tenderit ñKryerja e remontit të përgjithshëm të dy elektrovinqave 16-27.5 ton (për të cilën është lidhur kontrata me nr. 1771, datë 14.07.2011), dhe;

- tenderin për pjesë këmbimi eletrike, eletronike për vinca portual.
- tenderin për shërbimin për transportin e pjesëve të eletrovinqave.

- Ka kryer transferimin e 2 elektrovinqave 16-27 ton shoqërisë [REDACTED] ([REDACTED]) e përfaqësuar nga [REDACTED], sipas marrëveshjes së transferimit të mjeteve të terminalit lindor me nr. 1833 prot , datë 15.07.2013, me një diferencë nga shpenzimet e kryera për remontin e tyre në vlerën 22,800,000 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me ngarkimin, shkarkimin dhe transportimin e pjesëve të elektrovinqave, e cila nuk është bërë pjesë e kostos së remontit të vinqave, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, SKK dhe udhëzimin të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin dhe kontrollin financiarò.

3. zj [REDACTED] me detyrë drejtore e drejtorisë juridike.

Për arsye se:

Në funksion të detyrës si drejtore e drejtorisë juridike:

-Ka kryer shkelje të procedurave në lidhje me hartimin e amendimit të kontratës me nr. 1771, datë 14.07.2011 me objekt; ñKryerja e remontit të përgjithshëm të dy elektrovinqave 16-27.5 ton, amendim i cili ka shkelur barazinë në tender dhe ka krijuar një dëm ekonomik për llogari të buxhetit të shtetit në vlerën 22,800,000 lekë;

- Ka organizuar përveç tenderit ñKryerja e remontit të përgjithshëm të dy elektrovinqave 16-27.5 ton (për të cilën është lidhur kontrata me nr. 1771, datë 14.07.2011), dhe;

- tenderin për pjesë këmbimi eletrike, eletronike për vinca portual.
- tenderin për shërbimin për transportin e pjesëve të eletrovinqave.

- Ka kryer transferimin e 2 elektrovinqave 16-27 ton shoqërisë [REDACTED] ([REDACTED]) e përfaqësuar nga [REDACTED], sipas marrëveshjes së transferimit të mjeteve të terminalit lindor me nr. 1833 prot , datë 15.07.2013, me një diferencë nga shpenzimet e kryera për remontin e tyre në vlerën 22,800,000 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me ngarkimin, shkarkimin dhe transportimin e pjesëve të elektrovinqave, e cila nuk është bërë pjesë e kostos së remontit të vinqave, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, SKK dhe udhëzimin të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin dhe kontrollin financiarò.

4. zj [REDACTED] me detyrë drejtorisë ekonomike.

Për arsye se:

a. Në zhvillimin e procedurave të tenderit me objekt; ñKryerja e remontit të përgjithshëm të dy elektrovinqave 16-27.5 tonò, ka krijuar një dëm ekonomik për llogari të buxhetit të shtetit në vlerën 22,800,000 lekë.

b. Ka kryer kontabilizim të gabuar në llogaritë e kontabilitetit, duke i kaluar shpenzimet e transportit të pjesëve të këtyre eletrovinçave me anijet e shërbimit detar në vlerën 22,800,000 lekë, tek llogaria 6271 (llogaria shpenzime të ndryshme), dhe jo në llogarinë 231(llogaria aktive afatgjata) për të mos rritur vlerën kontabël të eletrovinçave. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 nëPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, SKK dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin dhe kontrollin financiarò.

c. Ka kryer transferimin e 2 elektrovinçave 16-27 ton shoqërisë [REDACTED] ([REDACTED]) e përfaqësuar nga [REDACTED] sipas marrëveshjes së transferimit të mjeteve të terminalit lindor me nr. prot 1833, datë 15.07.2013, me një diferencë nga shpenzimet e kryera për remontin e tyre në vlerën 22,800,000 lekë, në kundërshtim me ligjin 9228 datë 29.04.2004 nëPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò.

5. z [REDACTED] me detyrë drejtor i drejtorisë operacionale.

Për arsye se:

1. Në cilësinë e monitoruesit të kontratës nr. 1780/1 të datës 14.07.2011 të lidhur me shoqërinë [REDACTED]ò, për shërbime asistencë teknike për menaxhuesit e APD-së :

-Nuk është zbatuar nenin 19.2 të kontratës, përsa i përket 2-javë trajnimeve në vit që do kryhen në ambientet e APD-së.

-Produktet e punës të dorëzuara nga shoqëria [REDACTED]ò, janë kopje të printuara me ngjyra, pa autorësi, si rrjedhojë ky dokumentacion, nuk provon kryerjen e këtij shërbimi.

2. Në cilësinë e anëtarit të GIP dhe anëtarit të NJHDK në procedurën e dhënies me konçension me objekt: nëMenaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik dhe financimet e lidhura me to të Terminalit të kontejnerëveò, gjatë ushtrimit të detyrës nuk ka vlerësuar me korrektësi të gjitha detajet e projektit të paraqitur, pasi vlera e investimeve prej 32,500,000 USD të propozuara për përmirësimet teknike të terminalit nga koncesionari është në kundërshtim të plotë me marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet MPPT [REDACTED] më 31.08.2009 pika nëiò, faqe 4, ku përcaktohet se: ngritja e terminalit të kryhet në maksimumin 5 faza, ku punimet për fazën e parë, të jenë jo më pak se 40 milionë euro, që të shërbejnë kapaciteteve prej 150, 000 TEU/vit dhe të përfundojë brenda 3 (tre) viteve nga nënshkrimi i kontratës koncesionare. Investimi të realizohet kundrejt investimeve të kryera nga koncesionari, me financimin e tij dhe kredi të bankave të nivelit të dytë shqiptare dhe të huaja....ò, ku për pasojë ka sjellë një dëm për buxhetin e shtetit në vlerën prej **2,220 milionë lekë**.

Shënim: Për punonjësit [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED], të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar, rezultojnë se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës, për pasojë masa ndaj tyre konsiderohet e ezauruar.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Fatmir Iljazi, Lavdie Fshazi, Shefki Jaupi, Alfonc Gabili, më tej u shqyrtua nga k/auditues Bashkim Arizaj, Drejtori i Departamentit Xhafer Xhorxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT